



AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“2K GROUP” SH.P.K

Zoti **Koço KOKEDHIMA**, shtetas shqiptar, banues ne Tirane, si themelues i kesaj Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, ne te cilen ai eshte “Ortak i vetem”, vendosi te hartoje kete Akt Themelimi, mbeshtetur ne parimet e meposhtme:

Neni 1

Themeluesi krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta quaje “**2K GROUP**” SH.P.K

Neni 2

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane, ne rugen “5 Maji” tek ish ndermarrja kimike.

Me vendim te ortakut te vetem mund te ndryshohet selia e shoqerise, te hapen filiale te saj ose forma te tjera shoqerish, ashtu si kunder do ta shohe te nevojshme Shoqeria, brenda dhe jashte Shqiperise.


Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje kohe te pacaktuar, po sidoqofte mbi 10 vjet dhe do te filloje nga momenti i regjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar, me perjashtim te rastit kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos ortaku i vetem.

Neni 4


Si objekt i veprimtarise se saj Shoqeria do te kete:


- Studimin, projektimin, supervizionin dhe ndertimin e ndertesave publike, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digat dhe veprat bonifikuese e ujore, rehabilitimin e veprave ujtese, ujesjellesave, linjave mbitokesore e nentokesore per energji dhe telekomunikacionet, centralet dhe hidrocentralet, objektet turistike dhe te kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, realizimin e studimeve urbane, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstrukcionet e veprave te artit, montimet e prodhimet e konstruksioneve metalike dhe beton armeje, plastike te drurit dhe kombinime te ndryshme te tyre, prodhimin e konstruksioneve te dyerve, dritareve



dhe montimeve te veshjeve me duroalumin, prodhimin e materialeve te ndertimit, inerteve dhe asfaltobetonit, studime, projektme, mbikqyrje dhe menaxhim ne fushen e shfrytezimit te mineraleve, ne fushen e metalurgjise, dhe mbrojtjes se mjedisit, shkrirje, derdhje dhe perpunim plastik (ne te nxehte e ne te ftohte) te metaleve ferroze dhe jo ferroze, trajtimin e mbetjeve teknologjike, industriale, toksike dhe radioaktive trajtimin e ujrave industriale, prodhimin e bojrave dhe llakeve te ndryshme, te ambalazheve, çdo operacion industrial prodhues, prodhimin e vajrave te ndryshem ushqimore dhe joushqimore prodhimin e sapuneve, studime, projektme, mbikqyrje ne fushen e kerkimitdhe shfrytezimit te lendes drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave te kripura e kenetave, si dhe çdo veprimtari qe ka rendesi per shoqerine.

- Riparimin dhe remontet e mesme dhe kapitale te makinave elektrike rrotulluese te çdo tipi fuqie e tensioni, prodhimin e motorrave dhe transformatoreve elektrike, reaktoreve te çdo tipi dhe te gjitha pajisjeve elektrike deri ne prodhimin e tyre, transportin urban dhe interurban te punonjesve dhe udhetareve, servis per tipe te ndryshme te automjeteve, transportin ujqor, tokesor e ajror te mallrave dhe njerezve, konsulence teknike ne fusha te ndryshme, ngritjen e kurseve private per trainimin dhe specializimin e personave ne fusha te ndryshme, supervision, menaxhime dhe studime te te gjitha llojeve, realizimin e kontratave, marrveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo forma te tjera, veprimtari komisionere, konsulence ne fusha te ndryshme, perfaqesime, tranzitime, te lejuara nga legjislacioni shqipetar.
- Tregetimin dhe import-eksportin e mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, mjekesore, te materialeve te ndertimit, te aparaturave te mediave, te import-eksportit te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te pajisjeve e makinerive te ndryshme, te metaleve ferroze dhe joferroze, te lendes drusore, te lendeve te para kimike, biokimike, te perpunuara dhe gjysem te perpunuara per procesin e prodhimit, tregetimin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, shitblerjen e tokes, tregetimin e mallrave te gatshem e gjysem te gatshem .
- Botimin e gazetave, revistave, posterave, e reklamave dhe botimeve te tjera, shitje sherbimesh qe lidhen me kete fushe, realizimin e e impianteve te telekomunikacionit dhe sherbimet e nderlidhjes ne internet, konsulenca ne lidhje me to, administrimi, vendosja dhe perdorimi i impianteve fikse dhe te levizshme per transmetime radio-televizive drejtimi i televizionit dhe radios.
- Konsulence, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes se palnbizneseve,projekte zhvillimi dhe studime bëshmerise te efektiviteteve ekonomike, percaktimin e prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise, kryerjen e testeve, provave dhe matjeve laboratorike, ngritjen e laboratoreve dhe leshimin e çertifikatave per materialet e ndertimit, rrugeve, makinave elektrike, perzierieve kimike, nivelit te ndotjes se ambientit, karburanteve, produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, perberjen e shtresave te tokes dhe mineraleve, nivelit te zhurmave ne qendrat e banuara e industriale, vajrat izoluese dhe lubrifikante, bojrat dhe llaket, gjendjet dhe luhatjet sizmike lokale dhe rajonale etj.




• Administrim fondesh investimesh e ndermarrjesh, menaxhime ndermarrjesh, te ndryshme e shoqerish, mbikeqyrje punimesh e ndermarrjes, transaksione ne fusha te ndryshme etj.

- Kryerja e çdo operacioni ekonomik dhe juridik, industrial, prodhues, tregëtar e financiar, qe lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise. Brenda kuadrit te dispozitave ligjore, shoqeria do te kryeje çdo biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise do te jete 100.000 (njqindmije) leke, i zoteruar i gjithi nga ortakut i vetem.

Neni 6

Kapitali themeltar eshte depozituar prej tij ne nje Banke ne Shqiperi, me nje llogari te hapur ne emer te Shoqerise ne formim e siper.

Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga ajo Banke, ne te cilen shenohet shuma e kapitalit të derdhur.

Neni 7

Shoqeria do te rregullohet, pervec ketij Akti Themelues edhe me norma te percaktuara ne Statutin e saj, i cili pas nenshkrimit nga "ortaku i vetem" dhe noterizimit te tyre, do te paraqitet per miratim dhe regjistrim ne Gjykatën e Rrethit Tirane ne ditën e legalizimit si person juridik ne Shqiperi.

Neni 8

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 5 (pese) kopje, ne gjuhen shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore. Nga keto nje kopje do te depozitohet tek noteri nje kopje per tu regjistruar te dega e tatimeve dhe kopjet e tjera do te qendrojne ne arshiven e shoqerise.

THEMELUESI

KOÇO KOKEDHIMA





STATUTI I SHOQERISE

"2K GROUP" SH.P.K.

Neni 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Ortaku i vetëm Z Koço Kokëdhima, vendosi që të krijojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin "2K GROUP" Sh.P.K" në bazë të aktit të themelimit datë ___/06/1998 për të ushtruar aktivitetin e tij si person juridik i pavarur.

Neni 2

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në bazë të ligjit Nr.7638 datë 19/11/1992 "Për shoqëritë Tregëtare". Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar dhe personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregëtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 3

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "2K GROUP" sh.p.k. Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në këtë statut.

Neni 4

Selia e shoqërisë është në adresën Rr. "5 Maji" Tiranë.

Shoqëria do të ketë filiale dhe përfaqësi të saj edhe në rrethe të tjera të territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë territorit të Shqipërisë me miratimin e organeve kompetente.


Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me një vendim të ortakut të vetëm të saj.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Si objekt te veprimtarise se saj Shoqeria do te kete:

- Studimin, projektimin, supervizionin dhe ndertimin e ndertesave publike, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digat dhe veprat bonifikuese e ujore, rehabilitimin e veprave ujtesse, ujesjellesave, linjave mbitokesore e nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, centralet dhe hidrocentralet, objektet turistike dhe te kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, realizimin e studimeve urbane, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstrukcionet e veprave te artit, montimet e prodhimet e konstruksioneve metalike dhe beton armeje, plastike te drurit dhe kombinime te ndryshme te tyre, prodhimin e konstruksioneve te dyerve, dritareve dhe montimeve te veshjeve me duroalumin, prodhimin e materialeve te ndertimit, inerteve dhe asfaltobetonit, studime, projekte, mbikqyrje dhe menaxhim ne fushen e shfrytezimit te mineraleve, ne fushen e metalurgjise, dhe mbrojtjes se mjedisit, shkrirje, derdhje dhe perpunim plastik (ne te nxehte e ne te ftohte) te metaleve ferroze dhe jo ferroze, trajtimin e mbetjeve teknologjike, industriale, toksike dhe radioaktive trajtimin e ujrave industriale, prodhimin e bojrave dhe llakeve te ndryshme, te ambalazheve, çdo operacion industrial prodhues, prodhimin e vajrave te ndryshem ushqimore dhe joushqimore prodhimin e sapuneve, studime, projekte, mbikqyrje ne fushen e kerkimitdhe shfrytezimit te lendes drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave te kripura e kenetave, si dhe çdo veprimtari qe ka rendesi per shoqerine.
- Riparimin dhe remontet e mesme dhe kapitale te makinave elektrike rrotulluese te çdo tipi fuqie e tensioni, prodhimin e motorrave dhe transformatoreve elektrike, reaktoreve te çdo tipi dhe te gjitha pajisjeve elektrike deri ne prodhimin e tyre, transportin urban dhe interurban te punonjesve dhe udhetareve, servis per tipe te ndryshme te automjeteve, transportin ujqor, tokesor e ajror te mallrave dhe njerezve, konsulence teknike ne fusha te ndryshme, ngritjen e kurseve private per trainimin dhe specializimin e personave ne fusha te ndryshme, supervision, menaxhime dhe studime te te gjitha llojeve, realizimin e kontratave, marrveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo forma te tjera, veprimtari komisionere, konsulence ne fusha te ndryshme, perfaqesime, tranzitime, te lejuara nga legjislacioni shqipetar.
- Tregtimin dhe import-eksportin e mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, mjekesore, te materialeve te ndertimit, te aparaturave te mediave, te import-eksportit te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te pajisjeve e makinerive te ndryshme, te metaleve ferroze dhe joferroze, te lendes drusore, te lendeve te para





kimike, biokimike, te perpunuara dhe gjysem te perpunuara per procesin e prodhimit, tregetin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, shitblerjen e tokes, tregetin e mallrave te gatshem e gjysem te gatshem .

Botimin e gazetave, revistave, posterave, e reklamave dhe botimeve te tjera, shitje sherbimesh qe lidhen me kete fushe, realizimin e e impianteve te telekomunikacionit dhe sherbimet e nderlidhjes ne internet, konsulenca ne lidhje me to, administrimi, vendosja dhe perdorimi i impianteve fikse dhe te levizshme per transmetime radio-televizive drejtimi i televizionit dhe radios.

- Konsulence, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes se planbizneseve, projekte zhvillimi dhe studime beshmerise te efektiviteteve ekonomike, percaktimin e prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise, kryerjen e testeve, provave dhe matjeve laboratorike, ngritjen e laboratoreve dhe leshimin e certifikatave per materialet e ndertimit, rrugeve, makinave elektrike, perzierieve kimike, nivelit te ndotjes se ambientit, karburanteve, produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, perberjen e shtresave te tokes dhe mineraleve, nivelit te zhurmave ne qendrat e banuara e industriale, vajrat izoluese dhe lubrifikante, bojrat dhe llaket, gjendjet dhe luhatjet sizmike lokale dhe rajonale etj.
- Administrim fondesh investimesh e ndermarrjesh, menaxhime ndermarrjesh te ndryshme e shoqerish, mbikeqyrje punimesh e ndermarrjes, transaksione ne fusha te ndryshme etj.
- Kryerja e çdo operacioni ekonomik dhe juridik, industrial, prodhues, tregetar e financiar, qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise. Brenda kuadrit te dispozitave ligjore, shoqeria do te kryeje çdo biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj



Neni 6

KOHEZGJATJA

Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj mbi 10 vjet. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë e saj përpara këtij afati në rastet e prishjes ose likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në ligjin Nr.7638 datë 19/11/1992 "Për shoqëritë Tregëtare" në seksionin e V-të të tij.

Neni 7

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është caktuar në shumën 100 000 (njqind mijë) leke kjo e parashikuar në nenin 38 të ligjit Nr.7638 datë 19/11/1992 "Për Shoqëritë Tregëtare", i zotëruar i gjithi nga "ortaku i vetëm".

Neni 8

Kapitali themeltar i "ortakut të vetëm" është lirisht i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve e paraardhësve të tyre.. Me vullnetin e "ortakut të vetëm" kapitali themeltar mund t'u transferohet edhe personave të tretë. Në rast vdekjeje të "ortakut të vetëm" të Shoqërisë trashëgimtarët e tij mund të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit themeltar ose për likuidimin e shumës së kapitalit themeltar ose për vazhdimin e veprimtarisë duke respektuar rregullat e nenit 46 të ligjit Nr.7638 datë 19/11/1992 "Për Shoqëritë Tregëtare".

Neni 9

ASAMBLEJA

"Ortaku i vetëm" ushtron gjithë kompetencat që ligji Nr.7638 date 19/11/1992 i ka dhene asamblesë. Vendimet e "ortakut të vetëm" janë të detyrueshme për administratorin dhe personelin e shoqërisë kur keto jane konform ligjit dhe statutit.



Neni 10

“Ortaku i vetëm” ka të drejtë :

- Të emërojë dhe të shkarkojë administratën;
- Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj.
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej tij..
- Të japë aprovim për çdo veprim financiar që mund të kryhet nga administratori në vlerën mbi 10 000\$ USD.
- Të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr.7638 datë 19/11/1992 “Për Shoqëritë Tregëtare”.

Neni 11

ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga nje administrator i zgjedhur nga “ortaku i vetem” me afat kohor deri ne 1 (nje) vit, me te drejte rizgjedhje. Ne çdo rreth tjetër ku shoqëria “2K GROUP” ka filiale te saj administratori cakton nga nje administrator te emeruar prej tij i cili mbulon anen organizative te filialit dhe pergjigjet per punen e tij perpara administratorit te pergjithshem qe eshte “ortaku i vetem” i kesaj shoqërie. Rraportimin e punes se tyre administratorët e filialeve te shoqërisë do ta bejne ne mbledhjen e bordit drejtues te shoqërisë. Mbledhja e bordit drejtues, bashke me administratorët e filialeve te shoqërisë do te behet ne seline e shoqërisë me nje njoftim te thjeshte te administratorit te pergjithshem.

Neni 12

Ne qofte se administratori i shoqërisë “2K GROUP” qe eshte “ortak i vetem” i saj zoteron me shume se gjysmen e kapitalit te nje shoqërie tjetër te çfardo lloji qofte ajo, atehere shoqëria e dyte ne kuptimin e nenit 217 te ligjit Nr.7638 date 19/11/1992 “ Per shoqërite tregëtare” do te konsiderohet si filial i shoqërisë “2K GROUP”.



Neni 13

Administratori ka te drejte :

- Te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha marrdheniet e saj juridike dhe administrative brenda kopetencave te tij ;
- Te kryeje çdo veprim qe e shikon te arsyeshm dhe konform ligjit ;
- Te jape urdhera dhe udhezime personelit te shoqerise dhe te vendose sanksione ndaj tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kontratat e punes ;
- Te angazhoje shoqerine ne marrdhenit me te tretët nepermjet veprimeve qe jane ne perputhje me objektin dhe strategjine e shoqerise ;
- Te pranoje dhe largoje nga puna brenda shoqerise punemarres ne perputhje me dispozitat ne fuqi, brenda nevojave dhe organikes se percaktuar.

Neni 14

Administratori i shoqerise ka per detyre :

- Te punoje, drejtoje e te organizoje ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare;
- Te zbatoje vendimet e marra nga “**ortaku i vetem**” dhe urdherat e tij, te dhena brenda kopetencave te percaktuara nga statuti i shoqerise dhe legjislacioni ne fuqi ;
- Te paraqese ne menyre te rregullt raportin e administrimit, inventarit, bilancit dhe llogarite vjetore, “**ortakut te vetem**” brenda nje afati prej 6 muajsh duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar ;
- Te pergjigjet ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit te shoqerise si dhe per faje te kryera gjate administrimit ;
- Te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji Nr,7638 date 19/11/1992 “Per shoqerite tregetare”

Neni 15

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve administrative, gjyqesore ose te te treteve duhet firma e administratorit.

Neni 16

Ne rast pengesash si semundje, aksidente, udhetime te administratorit etj, “**ortaku i vetem**” ka te drejten e zevendesimit te perkohshem te tij.



Neni 17

Vula e Shoqerise ka forme te rrumbullaket, ne te cilen eshte shkruar :
Republika e Shqiperise, Shoqeria "2K GROUP"sh.p.k Tirane Albania

Neni 18

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Veprimet mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori i çdo filiali merr masa per nxjerrjen e bilancit vjetor te filialit te vet, te formuluar konform ligjit "Mbi kontabilitetin". Bilancet vjetore te çdo filiali te shoqerise duhet ti paraqiten administratorit te saj te pergjithshem brenda 6- muajorit te pare te vitit pasardhes.

Neni 19

Eshte kopetence e "ortakut te vetem" te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe perdorimin e tyre.

Neni 20

SHPERBERJA

Duke qene se ne çdo kohe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes "ortaku i vetem" vendos per menyren e likuidimit te saj, ne baze te ligjeve ne fuqi.

Shperberja e shoqerise mund te kerkohet nga nje ose disa kreditore te shoqerise te cilet kerkojne likuidimin e shoqerise per faktin se ajo nuk ka permbushur detyrimin ndaj tyre.

Neni 21

Per çeshtje qe s'parashikohen dhe rregullohen nga ky statut vlejne dispozitat e ligjit Nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare" seksioni per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari. Statuti u perpilua ne 5 (pese) kopje, me fuqi te barabarta per tu administruar ne organet gjyqesore dhe ato tatimore dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "2K GROUP".

Statuti u miratua nga ortaku i vetem dhe u nenshkrua rregullisht prej tij.

"ORTAKU I VETEM"

KOÇO KOKEDHIMA

